



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

**REKOMANDIME MBI “RAPORTIN E  
ANALIZËS SË REZULTATEVE TË  
PYETËSORËVE TË STUDENTËVE PËR  
VLERËSIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË  
SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA PREJ STAFIT  
NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV”!**

**VITI AKADEMIK 2022-2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përmbushje të Standardit V.5 të Kodit të Cilësisë “*Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) përfshin dhe angazhon studentë në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre*”, në Statutin e Universitetit të Vlorës, Neni 73, Pika d: “*Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në Universitet*”, si dhe të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Masave për Përmbushjen e Rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit për akreditimin e programeve të studimit si dhe akreditimin periodik institucional, gjatë vitit akademik 2022-2023 është implementuar për vitin e tretë radhazi instrumenti i Pyetësorit të Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik, miratuar me VSA Nr. 51 datë 20.09.2019, i ndryshuar me VSA Nr. 25, datë 12.05.2021. Ndër qëllimet kryesore të UV-së në përdorimin e këtij instrumenti përmendim:

1. *Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit*: Ky pyetësor ndihmon në vlerësimin e performancës së shërbimeve ndihmësakademike dhe administrative në aspektet e tyre efikase dhe efektive. Kjo përfshin kohën e pritjes për të marrë përgjigje, aftësinë për të zgjidhur çështje dhe për të siguruar ndihmë të nevojshme për studentët.
2. *Identifikimi i zonave të përmirësimit*: Përmes feedback-ut të studentëve, UV mund të identifikojë zonat konkrete ku shërbimet ndihmësakademike dhe administrative kanë nevojë për përmirësim. Kjo mund të përfshijë proceset e regjistrimit, ndihmën financiare, ose komunikimin në përgjithësi.
3. *Krijimi i kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm*: Duke inkurajuar studentët të japin feedback për shërbimet ndihmësakademike dhe administrative, universiteti krijon një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e përvojës së studentëve në të ardhmen.
4. *Ndikimi në vendimmarrjen*: Rezultatet e pyetësorit mund të përdoren si një nga burimet e informacionit në procesin e vendimmarrjes për investime, përmirësim teknologjike, ose rishikimet e politikave administrative brenda universitetit.
5. *Mbulimi i nevojave të studentëve*: Feedback-u i studentëve mund të ndihmojë në identifikimin e nevojave specifike të tyre në raport me shërbimet ndihmësakademike dhe administrative, duke lejuar universitetin të përshtatet me këto nevoja në mënyrë më efektive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

Në esencë, nëpërmjet këtij pyetësoni UV synon të sigurojë informacion të nevojshëm për krijimin e një panorame të qartë të nevojave të studentëve dhe efektivitetit të shërbimeve mbështetëse, për të përmirësuar eksperiencën e studentëve dhe për të bërë që UV të jetë më i përshtatshëm dhe efikas në ofrimin e shërbimeve.

Gjatë analizës së të dhënave prej NJSBCVI-së janë evidentuar edhe këtë vit disa problematika në nivel institucioni ku veçojmë:

**1. Pjesëmarrjen e ulët të studentëve:** Në pyetëson kanë marrë pjesë vetëm 7.6% e studentëve frekuentues gjatë vitit akademik 2022-2023, një shifër kjo edhe më e ulët në krahasim me vitet e mëparshme të implementimit të këtij instrumenti. Pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësonit mund të ketë disa ndikime, ku theksojmë:

- ✚ *Mungesa e informacionit të plotë:* Duke qenë se pyetësonin e kanë plotësuar një numër i vogël i studentëve, informacioni i mbledhur mund të mos jetë përfaqësues i plotë i nevojave dhe përvojave të studentëve në përgjithësi. Kjo mund të limitojë aftësinë për të identifikuar problemet dhe të ofrojë zgjidhje të përshtatshme në nivelin e universitetit.
- ✚ *Përfaqësim i paqartë i realitetit:* Pjesëmarrja e ulët mund të ketë rrezik që rezultatet të mos përshkruajnë me saktësi situatën reale. Kjo mund të çojë në gabime ose vlerësime të pavërteta në lidhje me cilësinë e shërbimeve.
- ✚ *Vështirësi në përmirësimin e shërbimeve:* Mungesa e pjesëmarrjes së lartë mund të vështirësojë universitetin për të kuptuar shqetësimet e vërteta të studentëve dhe për t'i adresuar ato. Për këtë arsye, zhvillimi i strategjive për të rritur pjesëmarrjen mund të jetë i rëndësishëm për të siguruar një vlerësim më të saktë dhe për të përmirësuar shërbimet në mënyrë efektive.
- ✚ *Mungesa e diversitetit të Feedback-ut:* Pjesëmarrja e ulët mund të rezultojë në një feedback të ngushtë dhe të kufizuar. Në rastin më të keq, kjo mund të çojë në përdorimin e zgjidhjeve të përgjithshme që nuk përshtaten me nevojat e të gjithë studentëve.

Për të adresuar këto sfida, është e rëndësishme të përdoren strategji për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në plotësimin e pyetësonit. Kjo mund të bëhet përmes intensifikimit të fushatave të informimit, ofrimit të incentivave për të marrë pjesë, përdorimit të platformave të reja ose duke siguruar që pyetësoni të jetë i lehtë për t'u aksesuar dhe plotësuar. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve do të ndihmonte në sigurimin e një feedback-i më të qëndrueshëm dhe më të saktë për të përmirësuar shërbimet mbështetëse në universitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

**2. Mungesa e të dhënave në nivel njësie kryesore/njësie bazë:** Mungesa e të dhënave për njësinë kryesore ose njësinë bazë ku studentët ndjekin studimet në rezultatet e pyetësorit mund të ketë ndikime të rëndësishme si:

- ✚ *Vështirësi në identifikimin e problemeve specifike:* Pa të dhëna të detajuara për njësinë bazë, është e vështirë për të identifikuar problemet specifike apo sfidat që studentët mund të përjetojnë në atë fushë studimi. Kjo mund të bëjë që rekomandimet për përmirësim të shërbimeve të jenë të përgjithshme dhe jo të përshtatshme për nevojat e tyre të veçanta.
- ✚ *Mospërputhja e rezultateve:* Pa të dhëna të njësisë bazë, rezultatet e pyetësorit mund të mos reflektojnë realitetin specifik të studentëve të atij programi apo njësie. Kjo mund të çojë në gabime në vlerësimin e nevojave reale të studentëve.

Për të adresuar këtë situatë, është e rëndësishme të sigurohet që pyetësorët për vlerësimin e shërbimeve të përfshijnë pyetje specifike që lidhen me njësinë bazë të studimit. Me qëllim identifikimin e njësisë kryesore/njësisë bazë të cilit i përkasin studentët, sugjerohet që pyetësori të plotësohet në llogarinë personale në UVMS. Në pamundësi të krijimit të një platforme specifike në pyetësor sugjerohet që në seksionin e katërt (të dhëna demografike) të shtohet edhe një pyetje mbi njësinë kryesor/njësinë bazë. Përmes këtyre pyetjeve, mund të mblidhen të dhëna të specializuara që mund të ndihmojnë në përmirësimin e përvojës së studentëve në fushën e tyre të studimit.

#### a) Sekretaritë mësimore

Kufizimi i mësipërm mbi mungesën e informacionit për njësinë kryesore/bazë e bën të pamundur identifikimin se cilat sekretari janë vlerësuar shumë mirë në krahasim me të tjerët, ku sipas studentëve kanë nevojë për përmirësim. Gjithësesi, në një vështrim të përgjithshëm mbështetur në rezultatet e pyetësorit gjatë vitit akademik 2022-2023, sekretaritë mësimore janë vlerësuar prej shumicës së studentëve pjesëmarrës në pyetësor se japin gjithmonë përgjigje të qarta dhe të drejtpërdrejta për pyetjet e drejtuara si dhe respektojnë etikën në komunikim. Nëse do të krahasojmë rezultatet e një viti më parë vërehet një rritje e numrit të studentëve që vlerësojnë këto pyetje pozitivisht (4.3% më tepër e studentëve kanë vlerësuar pozitivisht se sekretaritë japin përgjigje të qarta si dhe 4.1 % më tepër e studentëve kanë vlerësuar pozitivisht etikën në komunikim).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

Pavarësisht se kjo rritje evidentohet dhe në pyetjet e hapura ku studentët janë shprehur se nuk do të dëshironin të ndryshonin asgjë në sektor duke vlerësuar mirëkuptimin, shërbimin dhe sqarimin, një pjesë e studentëve do të dëshironin të përmirësonin një sërë aspektesh si saktësinë e informacionit, etikën, sjelljen, vonesat dhe mosmarrjen e përgjigjeve.

**Për të adresuar këtë situatë, rekomandojmë:**

***Përmirësimi i komunikimit:*** Të përmirësohet komunikimi me studentët duke qenë sa më i qartë dhe i rregullt nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit të disponueshëm. Të mundësohet qasje e lehtë në informacion, duke përfshirë platforma online, e-mail, posta të dedikuara, ose faqen zyrtare në internet.

***Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për monitorimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të studentëve.*** Mund të përdoret një sistem për monitorimin e kërkesave dhe kohëzgjatjen e përgjigjeve për t'i optimizuar këto procese.

***Trajnim i stafit dhe zhvillim profesional:*** Të zhvillohen programe trajnimi për stafin për të rritur aftësitë e tyre në ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe të përshtatshme për studentët. Këto trajnime mund të përmbajnë skenarë, raste studimore dhe udhëzime konkrete për sjelljen e duhur në situata të ndryshme.

**b) Zyra e Shërbimit ndaj Studentit**

Mbështetur në rezultatet e pyetësorit gjatë vitit akademik 2022-2023 vërehet se 53.9% e studentëve që kanë plotësuar pyetësorin e kanë frekuentuar rrallë ose asnjëherë zyrën e studentit (2% më pak se vitin e kaluar). Megjithatë për pjesën më të madhe të studentëve që kanë frekuentuar zyrën e studentit kanë vlerësuar dhënien e përgjigjeve të qarta dhe të drejtpërdrejta prej personelit të zyrës si dhe kanë respektuar etikën në komunikim. Ky rezultat evidentohet dhe në pyetjet e hapura ku studentët kanë pasur mundësi të shprehnin se çfarë do të donin të përmirësonin, ku rreth 58% e studentëve që i janë përgjigjur pyetjes së hapur janë shprehur se nuk do të dëshironin të ndryshonin asgjë ose të përmirësonin. Ndërsa pjesa tjetër e studentëve janë shprehur se do të dëshironin të përmirësohej akoma më tepër mënyra e komunikimit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

***Përmirësimi i komunikimit:*** Të përmirësohet komunikimi me studentët duke qenë sa më i qartë dhe i rregullt nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit të disponueshëm. Të mundësohet qasje e lehtë në informacion, duke përfshirë platforma online, email, posta të dedikuara, ose faqen zyrtare në internet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

*Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për monitorimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të studentëve.* Mund të përdoret një sistem për monitorimin e kërkesave dhe kohëzgjatjen e përgjigjeve për t'i optimizuar këto procese.

*Trajnimit dhe zhvillimit profesional:* Të zhvillohen programe trajnimit për stafin për të rritur aftësitë e tyre në ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe të përshtatshme për studentët. Këto trajnime mund të përmbajnë skenarë, raste studimore dhe udhëzime konkrete për sjelljen e duhur në situata të ndryshme.

**c) Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Aktiviteteve kulturore-sportive.  
(Alumni- studentë të diplomuar në vite në UV)**

Ende mbetet një problem evident pjesëmarrja e ulët e studentëve në aktivitetet që organizon ky sektor. Mbështetur në rezultatet e pyetësorit gjatë vitit akademik 2022-2023 vërehet se 45.2% e studentëve (14.7% më shumë se vitin e kalur) nuk janë përfshirë në aktivitetet e organizuara prej sektorit. Megjithatë një vlerësim pozitiv ky sektor ka marrë prej pjesës më të madhe të studentëve që kanë qenë pjesëmarrës qoftë edhe në një aktivitet përsa i përket etikës në komunikim të specialistëve të sektorit apo dhe cilësisë së aktiviteteve të organizuara. Pavarësisht rezultateve pozitive ende për një pjesë të konsiderueshme të studentëve duhet që të këtë më tepër aktivitete në funksion të programeve të studimit. **Për sa më sipër rekomandojmë:**

*Të mundësohet qasje e lehtë në informacion:* Sigurohuni që informacioni rreth aktiviteteve të ndryshme të jetë i aksesueshëm për studentët përmes platformave online, email-it, ose faqeve të internetit të dedikuara.

*Rritja e numrit të aktiviteteve në funksion të programeve të studimit:*

- Nxitni lidhjen dhe përdorimin e rrjeteve të Alumni-ve për të ofruar mentorim, praktika pune, ose sesione informative për studentët aktualë që t'u japin atyre një kuptim më të mirë të fushës së tyre të studimit.
- Përpiloni dhe implementoni aktivitete që lidhen ngushtë me programe të caktuara studimore për të ofruar përvoja shtesë dhe praktike për studentët.
- Nxitni përfshirjen e studentëve në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve, duke i bërë ata të ndihen pjesë të procesit duke reflektuar interesat e tyre specifike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

#### d) Sektori i Bibliotekës Shkencore

Edhe në këtë sektor vërehet një interes mjaft i ulët i studentëve për të frekuentuar bibliotekën onsite, si dhe atë online, ku rreth 61% e studentëve pjesëmarrës në pyetësor gjatë vitit akademik 2022-2023 e kanë frekuentuar rrallë ose asnjëherë. Sipas studentëve në pyetjet e hapura ky interes i ulët ka qenë kryesisht për mungesë informacioni nga ana e UV. Studentët të cilët e kanë frekuentuar bibliotekën gjatë vitit 2022-2023 kanë vlerësuar literaturën e saj, se i plotëson nevojat e studentëve, është respektuar etika në komunikim prej personelit të bibliotekës si dhe orari i shërbimit është i përshtatshëm për studentët. Ajo ç'ka studentët kanë veçuar si aspekte të cilat do të duhet të përmirësohen kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën, kapacitetin pritës si dhe mjetet e teknologjisë në dispozicion për studentët. **Për sa më sipër rekomandojmë:**

***Ndërtimi i strategjive të cilat ndihmojnë rritjen e interesit të studentëve për të frekuentuar bibliotekën dhe për të shfrytëzuar resurset që ofron ajo. Si të tilla sugjerojmë:***

- ***Sesione prezantuese:*** Organizimi i sesioneve informative në fillim të vitit akademik ose gjatë periudhës së orientimit për studentët e rinj. Këtu mund të prezantohen shërbimet, resurset dhe vendndodhja e bibliotekës në mënyrë të qartë dhe tërheqëse. Gjithashtu, vizita me guidë në bibliotekë është një mënyrë e shkëlqyer për të treguar studentëve vendndodhjen e bibliotekës, infrastrukturën dhe burimet që ofron ajo.
- ***Bërja e saj një ambient tërheqës:*** Hapësira e bibliotekës mund të bëhet një ambient i përshtatshëm për studim, duke ofruar zona të qeta, ambiente të përshtatshme për punë grupore, dhe akses në teknologji.
- ***Ofrimi i shërbimeve shtesë:*** Mund të ofrohen shërbime shtesë si sesione këshillimi për kërkime, trajnime për përdorimin e burimeve elektronike, ose asistencë në gjetjen e burimeve për punët studimore.
- ***Partneritet me stafin akademik:*** Bashkëpunimi i ngushtë me profesorët për të inkurajuar studentët të përdorin burimet e bibliotekës për punët e tyre studimore.
- ***Krijimi i një ambienti komunitar:*** Të nxitet krijimi i një komuniteti nëpërmjet klubeve të librit, grupimeve studimore, diskutimeve tematike, ose aktiviteteve të tjera që inkurajojnë bashkëveprimin dhe ndarjen e informacionit.
- ***Investime në teknologji të reja:*** Pajisjet e reja, kompjuterat e avancuar, lidhjet e shpejta të internetit, dhe pajisjet e tjera teknologjike mund të përmirësojnë përvojën e përdoruesve në bibliotekë.

#### e) Laboratorët /Qendrat Kërkimore Shkencore pranë Fakulteteve

Rezultatet jo të mira përsa i përket frekuentimit prej studentëve janë dhe Qendrat Kërkimore Shkencore në fakultete, ku rreth 50 % e studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor nuk i kanë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

frekuentuar asnjëherë gjatë vitit akademik 2022-2023. Frekuentimi i këtyre qendrave sjell përvojë të çmuar për studentët, duke ofruar mundësinë për të punuar me profesorë dhe ekspertë në fushën e tyre. Ato ofrojnë mundësinë për të eksploruar tema të ndryshme, për të kuptuar thellësisht koncepte të mësuara në klasë dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre kërkimore. Prandaj është e rëndësishme që profesorët të nxisin frekuentimin e QKSH nëpërmjet projekteve apo detyrave kërkimore apo organizmit të orëve të hapura pranë këtyre qendrave.

Për pjesën më të madhe të studentëve të cilët kanë frekuentuar laboratorët/qendrat kërkimore vlerësojnë etikën në komunikim të stafit ndihmës akademik si dhe infrastrukturën logjistike. Megjithatë për rreth 20% të tyre infrastruktura logjistike e laboratorëve ka nevojë për përmirësime. Ky fakt del më në pah dhe në pyetjet e hapura ku studentët janë shprehur se është i nevojshëm pasurimi i laboratorëve me mjete të reja e bashkëkohore si dhe infrastrukturën fizike të tyre apo shtimin e laboratorëve të tjerë. **Për sa më sipër rekomandojmë:**

***Të gjenden mekanizmat e nevojshëm për të stimuluar frekuentimin e QKSh në fakultetet respektive:*** Organizmi i aktiviteteve të tilla si projekte apo detyrave kërkimore apo organizmi i orëve të hapura, janë disa nga instrumentat që do të nxisin frekuentimin e këtyre qendrave. Gjithashtu, QKSH duhet të jenë promotor të përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor si psh nëpërmjet organizimit të ditëve kërkimore, etj.

***Të vlerësohet gjendja fizike e laboratorëve ekzistues (kryesisht të FSH, dhe FSHTN) në funksion të përmirësimit të organizimit të orëve laboratorike:*** Përmirësimet e laboratorëve kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit dhe eksperiencës së studentëve. Një angazhim i vazhdueshëm për të përmirësuar këto ambiente do të ndihmojë në përmirësimin e aftësive shkencore dhe teknologjike të studentëve. Strukturave përgjegjëse në UV të bëjnë një vlerësim të nevojave për secilin laborator me qëllim identifikimin, cilat pajisje janë të vjetra, të dëmtuara ose të pamjaftueshme për nevojat e aktualizuara, në mënyrë që të planifikohet në buxhet përditësimi i bazës logjistike me teknologjitë më të reja apo dhe ndërtimi i laboratorëve të rinj në funksion të procesit mësimor apo punimit të pavarur të studentëve.

#### **f) Sektori i IT-së**

Përgjithësisht gjatë vitit akademik 2022-2023 studentët kanë vlerësuar pozitivisht shërbimet IT të ofruara në UV. Megjithatë pavarësisht pyetjeve të mbyllura ku përgjithësisht rezultatet në pyetësorë tregojnë një performancë shumë të mirë të sektorit IT, në pyetjen e hapur studentët janë shprehur se shpesh herë hasin vështirësi në aksesim, në azhurnimin e sistemit UVMS apo në përditësimin e informacionit në kohë. **Për sa më sipër rekomandojmë:**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**GRUPI I PUNËS AD HOC**

- Të përditësohet informacioni i lidhur me procesin mësimor dhe aktivitetet të ndryshme si dhe të publikohet në kohë në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të UV-së.
- Të shtohet numri i shërbimeve online, në mbështetje të linjës strategjike Smart UV, duke i lehtësuar marrjen e shërbimeve studentëve.

Mbështetur në rekomandimet e një viti më parë nevojitet më tepër impenjim nga struktura IT në përmbushjen e sugjerimeve të dala prej studentëve duke qenë se ato janë të njëjtat me një vit më parë.

### **g) Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë**

Mbështetur në rezultatet e përgjigjeve për këtë sektor vihet re se 50% e studentëve janë shprehur se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë ose rrallë herë në aktivitetet e realizuar prej SPMJ, një shifër kjo e cila kërkon akoma edhe më tepër angazhim pavarësisht se ka një përmirësim të rezultatit me 12.6% më e ulët se një vit më parë. Për pothuajse të gjithë studentët që kanë marrë pjesë në pyetësorë, personeli i SPMJ ka respektuar etikën në komunikim si dhe i kanë vlerësuar aktivitetet e organizuara prej SPMJ. Ndërsa për një pjesë të konsiderueshme të studentëve aktivitetet e organizuara janë të pamjaftueshme si dhe duhet të kenë më tepër mundësi informimi.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Të organizohen ditë informuese prej SPMJ për informimin e studentëve mbi shërbimet dhe aktivitetet që ofrohen prej sektorit.
- Të planifikohen më tepër aktivitetet prej SPMJ me qëllim përmbushjen e kërkesave të studentëve.

Mbështetur në rekomandimet e një viti më parë nevojitet më tepër impenjim nga sektori në përmbushjen e sugjerimeve të dala prej studentëve duke qenë se ato janë të njëjtat me një vit më parë.

### **h) Vlerësimi Infrastrukturës**

Studentët (40% e tyre) vijnë të vlerësojnë si të keq apo shumë të keq sistemin e ngrohje/ftohjes si dhe higjienën e tualeteve (37% e tyre, me një përmirësim prej 3.6% në krahasim me një vit më parë). Për aspekte të tjera si mjediset e auditorëve, sistemin e ndriçimit, cilësinë e bazës materiale, janë ndërmarrë disa masa nga UV si vihet re dhe nga përgjigjet pozitive të studentëve krahasuar me një vit më parë.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
GRUPI I PUNËS AD HOC

- Të parashikohet në buxhetin e UV përmirësimi i kushteve të sistemit të ngrohje/ftohjes së auditorëve, kryesisht në FSH. Të merren masa që ambientet të jenë të izoluar mirë për të ruajtur temperaturën e përshtatshme në auditorë. Nëse izolimi është i dobët, mund të konsiderohet investimi në izolim të ri për të mbajtur më mirë temperaturën. Të investohet në ndërtimin e sistemeve të ngrohje/ftohjes në fakultete, si dhe të vihet në punë sistemi i ngrohjes në FSHTN.
- Të përmirësohet higjena e tualeteve, duke plotësuar të gjitha standartet higjeno-sanitare.

Pavarësisht investimeve të realizuara një vit më parë në zbatim të rekomandimeve të lëna prej grupit të punës ende është e nevojshme të ndërmerren investime të tjera.

## GRUPI I PUNËS

- Prof. As Frosina Londo Qyrdeti (Zv. Rektor) - **Kryetar**
- Prof. As Enkelejd Mëhilli (Zv. Rektor) - **Anëtar**
- Prof. As Denada Sota (Zv. Dekan-FSHTN) – **Anëtar**
- Dr. Amalia Çipi (Zv. Dekan-FE) – **Anëtar**
- Dr. Erjona Dervishaliaj (Zv. Dekan-FSHH) - **Anëtar**
- Dr. Rezarta Lalo (Zv. Dekan-FSH) - **Anëtar**
- Entela Islamaj (DSHM) - **Anëtar**
- Romina Xhelaj (NJSBCVI) - **Anëtar**
- Laura Allushaj (Anëtar I Senatit Akademik, student) – **Anëtar**